



## THIRRJE PËR OFERTIM

### ANKETAT PËR INDEKSIN KOSOVAR TË SHOQËRISË CIVILE 2018

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile fton kompanitë ose OJQ-të hulumtuese që të ofertojnë për realizimin e anketave dhe fokus grupeve për nevoja të Indeksit Kosovar të Shoqërisë Civile 2018. Indeksi Kosovar i Shoqërisë Civile është një studim i rregullt i KCSF-së që vlerëson gjendjen e shoqërisë civile në Kosovë në baza periodike. Metodologjia e hulumtimit përfshin burime të ndryshme të të dhënave, përfshirë anketa në terren.

Kompania/organizata e kontraktuar do të udhëheqë dhe realizojë punët rreth mbledhjes, organizimit, analizës së të dhënave të mbledhura në terren, dhe shkrimin e raportit përshkrues të të dhënave për Indeksin Kosovar të Shoqërisë Civile 2018.

Afati i fundit për aplikim është më 16 tetor 2017 (e Hënë), në orën 14:00.

#### INFORMATA MBI KCSF-NË

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) është organizatë e pavarur jo për përfitim e cila bën bashkë profesionistë me përvojë dhe të rinj të përkushtuar për të fuqizuar shoqërinë civile dhe për të përkrahur perspektivën e integritit europian të Kosovës. KCSF beson në dy parime kryesore: 1) që një shoqëri civile e fuqishme dhe efektive është aktor i pazëvendësueshëm për avancimin e tranzicionit demokratik të Kosovës; dhe 2) perspektiva e integritit europian është shtytësi më i fuqishëm i reformave vendore në Kosovë.

E fokusuar në dy fushat kryesore programore, KCSF është e organizuar në tre njësi kryesore funksionale:

1. Njësia e grantimit – e fokusuar në ofrimin e përkrahjes financiare dhe jo-financiare për OShC-të vendore;
2. Qendra e KCSF-së – e fokusuar në ofrimin e informatave dhe ngritjen e kapaciteteve të OShC-ve dhe aktorëve tjerë relevant për zhvillimin e shoqërisë civile;
3. Njësia e hulumtimit dhe avokimit – e fokusuar në ofrimin e argumenteve dhe rekomandimeve faktike, për avokim në fushat kryesore të KCSF-së.

Në punën e vet, KCSF ka siguruar përkrahje afat-gjatë nga një grup i gjerë i donatorëve, përfshirë Sida-n suedeze, Zyren zvicerane për bashkëpunim në Kosovë, Bashkimin Europian, Ambasadën norvegjeze në Kosovë, Qeverinë e Luksemburgut, Fondacionin për shoqëri të hapur, etj.

Indeksi Kosovar i Shoqërisë Civile 2018 përkrahet nga projekti “Promovimi i Shoqërisë Demokratike – DSP II”, e financuar nga Zyra zvicerane për bashkëpunim në Kosovë, ndërsa KCSF përkrahet nga Sida, nëpërmjet përkrahjes institucionale për KCSF-në në arritjen e misionit dhe zbatimin e strategjisë së vet.



## **MBI INDEKSIN KOSOVAR TË SHOQËRISË CIVILE**

Indeksi Kosovar i Shoqërisë Civile është një studim i rregullt i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile. Ky studim vlerëson gjendjen e shoqërisë civile në Kosovë në baza periodike, duke matur dimensionet kryesore të këtij sektori, siç janë: struktura e sektorit, korniza ligjore, qeverisja dhe kapacitetet e brendshme, angazhimi qytetar, financimi, ndikimi i perceptuar dhe ambienti i jashtëm për veprimtari të shoqërisë civile.

Ky studim e vazhdon traditën e KCSF-së në ofrimin e informatave gjithëpërfshirëse mbi sektorin e shoqërisë civile në Kosovë, e filluar me [Antologjinë e shoqërisë civile më 2001](#), [Analizën e shoqërisë civile në Kosovë më 2005](#), [Indeksin e Shoqërisë Civile për Kosovë të CIVICUS më 2011](#), [Indeksin Kosovar të Shoqërisë Civile më 2014](#) dhe [Indeksin Kosovar të Shoqërisë Civile më 2016](#). Ky studim realizohet çdo dy vite dhe i vlerëson dimensionet kryesore të sektorit të shoqërisë civile në Kosovë.

Metodologjia e studimit bazohet në botimet e kaluara të Indeksit të Shoqërisë Civile, por ka përshtatje të metodave hulumtuese për të adresuar krakteristikat e veçanta të shoqërisë civile në Kosovë. Metodologjia përfshin hulumtimin e literaturës dhe rishikimin e kornizës ligjore, anketa, diskutime në grupe të fokusit dhe analizë të të dhënave.

Duke paraqitur shpjegime të detajuara të një numri të madh të indikatorëve, raporti i plotë i Indeksit Kosovar për Shoqëri Civile u dedikohet për përdorim ekspertëve, hulumtuesëve dhe profesionistëve, si dhe vendim-marrësve në institucionet publike, organizatat donatore dhe OShC-të të cilat merren me sektorin e shoqërisë civile. Gjithashtu, për të pasur një shtrirje më të gjerë te audiencat e ndryshme, Indeksi Kosovar i Shoqërisë Civile 2018 do të ketë edhe një vistër të produkteve të tjera publike, të cilat në mënyra të ndryshme do të sjellin informata të përmbledhura ose të thelluara të dimensioneve të ndryshme të sektorit të shoqërisë civile në Kosovë.



## KUSHTET E VEÇANTA TË ANGAZHIMIT TË EKSPERTIT TË JASHTËM

### Qëllimi i kontraktimit

Kompania/organizata e kontraktuar do të udhëheqë dhe realizojë punët rreth mbledhjes, organizimit, analizës së të dhënave të mbledhura në terren, dhe shkrimin e raportit përshkrues të të dhënave për Indeks Kosovar të Shoqërisë Civile 2018.

### Detyrat dhe përgjegjësitë e veçanta

Kompania/organizata e kontraktuar duhet të ndërmarrë veprimet e renditura më poshtë:

1. Mbledhja dhe organizimi i të dhënave sasiore dhe cilësore
  - a. Operacionalizimi i mostrave të hulumtimit, bazuar në formulat e mostrimit të përgatitura nga KCSF;
  - b. Anketimi në terren i 101 organizatave të shoqërisë civile, në kuadër të Anketës me OShC;
  - c. Anketimi në terren i 101 individëve nga sektorë të ndryshëm jashtë shoqërisë civile, në kuadër të Anketës së Perceptimeve të Jashtme
  - d. Futja e të dhënave nga anketat në format të përshtatshëm dhe lehtë të përdorshme, duke përfshirë bazën e të dhënave në format Excel dhe dokumentin sqarues të bazës së të dhënave (Code Book);
  - e. Mbledhja dhe sistemimi i pyetësorëve të plotësuar;
  - f. Organizimi dhe udhëheqja e së paku 5 fokus grupeve me qëllim të mbledhjes së të dhënave shtesë dhe/ose validimit të të dhënave të dala nga anketat;
2. Analiza e të dhënave
  - a. Analiza e të dhënave sasiore përmes programeve kompjuterike për analiza statistikore (SPSS, STATA), duke përfshirë krostabulime, korrelacione, regresione, etj.;
  - b. Nga krahasimi me të dhënat e viteve paraprake të ofruara nga KCSF, analiza dhe paraqitja e trendeve për kategori të caktuara të të dhënave, të identifikuar paraprakisht nga KCSF;
  - c. Analiza dhe përmbledhja e të gjeturave nga diskutimet e fokus grupeve;
3. Raporti përshkrues i të dhënave
  - a. Kompania/organizata duhet të propozojë strukturën fillestare të raportit përshkrues të të dhënave. Pas aprovimit nga KCSF, kompania duhet të pasqyrojë në mënyrë të qartë dhe të rrjedhshme të gjitha elementet e aprovuara paraprakisht;
  - b. Raporti përshkrues i të dhënave duhet të përmbajë të dhëna sasiore (Anketa me OShC dhe Anketa e Perceptimeve të Jashtme) dhe të dhëna cilësore (diskutimet në fokus grupe);
  - c. Të gjitha burimet e informatave duhet të paraqiten në formë të referencave, si në tekst, ashtu edhe si shtojcë e raportit;
  - d. Përveç pjesës narrative, raporti duhet të përmbajë paraqitje të qartë grafike dhe/ose tabelare të të dhënave;
4. Ofrimi i shërbimeve shtesë, të vazhdueshme për analiza statistikore



- a. Edhe pas dorëzimit të raportit përshkrues të të dhënave, kompania duhet të ofrojë shërbime për analiza shtesë statistikore për KCSF-në deri në Qershor 2018, nëse një gjë e tillë vlerësohet si e nevojshme.

### **Mënyra e ofertimit**

Ofertimi i kompanive duhet bëhet për njësi të ndara, respektivisht pikat 1 deri në 4. Varësisht prej shumës totale të ofertës, KCSF ruan të drejtën e kontraktimit të vetëm disa njësjive.

Për pikën 4, Ofrimi i shërbimeve shtesë, oferta financiare duhet të kalkulohet për ditë pune.

### **Produktet e pritura**

1. Bazat e organizuara të të dhënave nga Anketa me OShC dhe Anketa e Perceptimeve të Jashtme;
2. Dokumenti sqarues i bazës së të dhënave (Code Book)
3. Përmbledhje e diskutimeve të fokus grupeve;
4. Raporti përshkrues i të dhënave.

### **Kush mund të aplikojë**

1. Kompanitë private ose organizatat jo-qeveritare të regjistruara në Kosovë, të specializuara në fushën e hulumtimeve.

### **Kualifikimet dhe ekspertiza e kërkuar**

1. Përvojë të dëshmuar në fushën e hulumtimeve, me theks të veçantë në hulumtimet sasiore dhe anketimin në terren;
2. Staf profesional të angazhuar për udhëheqjen dhe menaxhimin e hulumtimeve, përfshirë analizën e të dhënave;
3. Kapacitete të mjaftueshme teknike dhe njerëzore për ofrimin e shërbimeve të kërkuara (anketues të terrenit, programe statistikore, etj.);

### **Dokumentet për aplikim**

1. Qasjen e propozuar për realizimin e punëve;
2. Referencat nga punët/projekte të ngjashme;
3. CV-të e stafit kyç që do të angazhohen në këtë kontratë;
4. Ofertën e detajuar financiare (përveç shumës për secilën kategori, oferta të përshijë shumën totale pa TVSh);
5. Certifikatën e regjistrimit të biznesit ose OJQ-së dhe certifikatën e numrit fiskal.

### **Mënyra dhe afati për aplikim**

Dosjet e aplikimit, me të gjitha dokumentet e kërkuara, duhet të dërgohen me e-mail në [hulumtimi@kcsfoundation.org](mailto:hulumtimi@kcsfoundation.org) ose të dorëzohen në kopje fizike në zyrat e KCSF-së, Rr. Fazli Greiçevci 55,



në Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 09:00 deri në orën 14:00. Afati i fundit për aplikim është më 16 tetor 2017 (e Hënë), në orën 14:00.

Kompanitë/organizatat e interesuara mund të kenë qasje në pyetësorët parafinal të anketave duke e kërkuar këtë nëpërmjet e-mailit [hulumtimi@kcsfoundation.org](mailto:hulumtimi@kcsfoundation.org).

### **Afatet**

Afatet për detyrat e veçanta janë si në vijim:

- a. Kontraktimi i kompanisë – Pjesa e dytë e muajit tetor 2017;
- b. Trajnimi i hulumtuesëve për realizimin e anketave në terren – tetor 2017;
- c. Anketa me OShC – nëntor 2017;
- d. Anketa e Perceptimeve të Jashtme – nëntor 2017;
- e. Futja dhe organizimi i të dhënave kuantitative dhe kualitative – nëntor – dhjetor 2017;
- f. Analiza e të dhënave – dhjetor 2017;
- g. Drafti i parë i raportit – pjesa e dytë e dhjetorit 2017;
- h. Organizimi dhe udhëheqja e diskutimeve të fokus grupeve – janar 2018;
- i. Drafti përfundimtar i raportit – pjesa e dytë e muajit janar 2018;
- j. Ofrimi i shërbimeve shtesë – muajt shkurt deri në qershor 2018.

### **Gjuha e punës**

Të gjitha draftet e materialeve dhe raporti përfundimtar i prodhuar në kuadër të këtij angazhimi do të bëhen në gjuhën shqipe.

### **E drejta e përdorimit**

Të gjitha informatat, analizat dhe materialet e prodhuara në kuadër të këtij angazhimi mbesin pronë intelektuale e KCSF-së. Kompania e kontraktuar duhet të përmbahet nga përdorimi i informatave, analizave apo materialeve të marra në posedim ose të prodhuar nga ky angazhim për çfarëdo qëllimi tjetër, përveç nëse një gjë e tillë bëhet në marrëveshje me shkrim me KCSF-në. Ky kufizim përfshin edhe periudhën e zbatimit të këtij angazhimit.

Prishtinë, 27 shtator 2017